



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 09.05. 2022, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Flutura Aça – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Diskutimi dhe miratimi i kalendarit të punës së komisionit për periudhën 6 – 27 maj 2022.

Marrin pjesë:

Flutura Aça, Petro Koçi, Besion Ajazi, Eduard Ndreca, Teuta Ramaj, Lindita Buxheli, Ilir Topi, Florenc Spaho, Dasantila Tahiraj, Blerina Gjylameti, Enslemvera Zake, Meri Markiçi, Luçiano Boçi, Agron Gjekmarkaj, Ina Zhupa, Eralda Bano, Merita Bakiu, Kastriot Piroli.

Mungojnë:

Andia Ulliri.

HAPET MBLEDHJA

Flutura Aça – Përshëndetje, kolegë deputetë!

Fillojmë mbledhjen e datës 9 maj 2022 të Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Sot në rendin e ditës kemi miratimin e kalendarit për datat 9-27 maj 2022.

Për procedurë, do të doja të shtoja diçka, nëse më lejohet, në lidhje me çfarë ka ndodhur në mbledhjen e fundit të datës 26 prill 2022, kur unë nuk kam qenë e pranishme, gjithashtu edhe disa deputetë nuk kanë qenë të pranishëm për arsye njerëzore, ku është diskutuar një çështje shumë e ndjeshme, si ajo e Butrintit. Pra, deputetët që kanë munguar mbledhjen e kaluar mbase kanë diçka për të thënë, pasi ajo që ka kaluar në komision nuk është gjë e vogël, nuk janë respektuar disa rregulla elementare bazë, të cilat i kemi vendosur bashkë edhe në ditën që kemi bërë betimin para shqiptarëve, por edhe si anëtarë të këtij komisioni.

Në syrin tim, atë ditë është konsumuar shkelja e nenit 23 të Rregullores së Kuvendit dhe nenit 39/1 të Rregullores së Kuvendit.

Këtu ka ardhur një draft vetëm me dy nene, ju e dini, dhe është miratuar menjëherë, pa u konsultuar fare me asnjë material bazë. Unë do të doja të dija prej jush, këtë pyetje publike e kam për secilin prej jush: cili prej jush është konsultuar me këtë draft, sepse ky draft ka munguar atë ditë në mbledhjen tonë?

E dyta, kush prej jush ka vizituar Butrintin përtej Butrintit, domethënë jo vetëm Butrintin, por të gjitha zonat që thonë këta, zonat e nënzonat, peizazhet e të tjera, se këta fjalë kanë shumë?! Këto pyetje kam për kolegët e mi.

Ky dokument shumë i rëndësishëm, për të cilin duhet të diskutonim, nuk është paraqitur në komisionin tonë, qoftë edhe si komision për dhënie mendimi, ndërkohë që kemi pasur detyrimin ta kishim dhe nuk jemi konsultuar me të, pasi ka munguar. Ministrja në komisionin tonë ka deklaruar që është sekret, kur, në fakt, pas zhurmës që është bërë, u është adresuar komisioneve të tjera, si atij të Ekonomisë, por në komisionin tonë ka munguar.

Ne kemi kaluar një çështje me sytë mbyllur dhe nuk dimë asgjë se çfarë ka ndodhur. Flas për veten time, të paktën në shtëpinë time nuk pranoj të ndodhin gjëra, të cilat, në fund të fundit, janë krime të trashëgimisë kulturore, gjë për të cilën unë dhe njerëz që merren me kulturën këtu

kemi luftuar sot e 30 vjet. Kështu që, unë nuk mund ta lë të kalojë kaq lehtë një çështje kaq të rëndësishme.

Kush e do fjalën? Zoti Boçi.

Luçiano Boçi – Faleminderit!

Shqetësimin e kryetares së komisionit unë e gjej me vend, në radhë të parë, jo thjesht për pjesën e mungesës së anës sonë, të opozitës, në diskutimet për ligjin, sepse nuk është konsideruar ana njerëzore, ndoshta procedura është më e fortë se ana njerëzore në rastet e politikës. Unë e kuptoj politikën, por s'mund ta kuptoj politikën pastaj kur ajo mashtron dhe shet draftet apo projektligjet që vijnë para këtij komisioni.

Përgjatë përvojës sime parlamentare nuk ka ndodhur asnjëherë kjo që kryetarja e komisionit e relatoi para nesh, që këtu të diskutohet një minidraft i cunguar në totalitetin e tij dhe debati të bëhet mbi një bazë fillestare, pa zbuluar atë që përmban projektligji, në rastin konkret, dëmet që sjell për Butrintin, pasojat për trashëgiminë kulturore dhe pasoja të tjera.

Mbulimi nën siglën “sekret” nuk shkon, sepse në qoftë se do të ishte sekret le të shkonte te Komisioni i Sigurisë, pasi ne nuk e kemi certifikatën e sigurisë së trajtimit të çështjeve sekrete shtetërore dhe mund ta jepnin ata mendimin. Këtë e them për ironi, sigurisht! Ne jemi komision përgjegjës dhe gjithçka duhet të kalonte para komisionit tonë.

Meqenëse ky fakt është verifikuar dhe, në qoftë se qëndrojmë te denoncimi, te fjalët, nuk kemi thënë asgjë, pasi ai ka marrë rrugën e miratimit, ka kaluar edhe në Kuvend dhe para këtij fakti ne jemi me duar lart, të dorëzuar, thjesht dhe vetëm mund të irritohemi e të bërtasim.

Çështja që unë kërkoj të parashtoj dhe njëkohësisht mendoj se duhet të bashkëpunojmë, për nder të këtij komisioni, për nder edhe të të qenit deputetë është: a kemi mundësi ligjore si komision të kërkojmë rikthimin e diskutimit për këtë projektligj, pavarësisht se ka një vendim seance, ku ne të shprehim mendimet tona, të plotësuara tashmë, në bazë të draftit të plotë të çështjes së marrëveshjes për Butrintin? Pra, ne jemi mashtruar edhe ju, edhe ne, se ne nuk kemi qenë pjesëmarrës në miratimin e draftit, por së paku, për sedër politike, por edhe për sedër njerëzore, ne duhet të reagojmë. Ndaj, kërkojmë bashkëpunimin tuaj. S'mund të ndodhë që ne të kalojmë një projektligj të sjellë në formë të cunguar. Vërtet ndonjëherë ndodh që deputetët të mos i lexojnë të gjitha projektligjet, sepse ngarkesa ndonjëherë të shtyn t'i kalosh tangent, por për këtë projektligj, që ka pasur shumë debate dhe ka një vendimarrje jo të plotë, përderisa ne kemi munguar, duhet të reagojmë patjetër si komision.

Minimalisht këtë e kërkoj edhe nga juristët, duhet të gjejmë rrugën ligjore që projektligji të rikthehet dhe të diskutohet i plotë. Ne nuk kemi diskutuar për një projektligj të plotë, por na kanë gënjyer. Në qoftë se ju e pranoni, është çështja e moralit tuaj politik dhe njerëzor njëkohësisht. Ne kurrsesi nuk kemi për ta pranuar një gjë të tillë.

Faleminderit!

Petro Koçi – Faleminderit, zonja kryetare!

Mirë se erdhët në komision dhe suksese në detyrën e drejtimit të këtij komisioni! Të shpresojmë me profil të moderuar!

Për sa i përket çështjes që u ngrit, së pari, ne kur fillon mbledhjet, aprovojmë rendin e ditës. Mendoj se ky diskutim mund të bëhej nëse ne do të shtonim edhe një pikë të dytë në rendin e ditës “Çështje të tjera”, pra duhej që në fillim të diskutonim kalendarin e paraqitur, ta kalonim atë, pastaj, me shumë mirëkuptim, mund të diskutonim edhe një çështje shtesë.

Gjëja tjetër që dua të them është se ky komision nuk është përgjegjës, mund të ishte përgjegjës, dhe në konsideratën time personale mendoj se ne mund të ishim, por nuk jemi për këtë çështje.

E dyta, projektligji është vërtet me dy pika, kështu ka ardhur. Ajo që ka munguar atë ditë ka qenë një i ashtuquajtur plan biznesi. Unë që po flas jam nga njerëzit më skeptikë për këto rastet e trajtimit dhe administrimit të çështjes së pronave publike e të tjera nga privatët, por, gjithsesi, nganjëherë përvoja më ka zhgënjyer pozitivisht, siç është rasti i stadiumit “Qemal Stafa” e kështu me radhë; e them këtë, sepse nuk dua të paragjykoj asnjë projekt që vjen.

Tjetra që dua të shtoj është se projektligji ka pasur një relacion të qartë dhe të gjatë, që është shumë i rëndësishëm, sa herë shqyrtohen materialet dhe dokumentet që shoqërojnë një projektligj; tjetra është që marrëveshja ka qenë e depozituar në Kuvend dhe cilido deputet mund t’i shihte, ndoshta jo në detaje, por ato pjesët më të rëndësishme të marrëveshjes që ka bërë qeveria me fondacionin. Unë besoj se kush ka pasur dëshirë e ka gjetur mundësinë ta bëjë këtë gjë.

Tjetra që dua të shtoj si argument, është se ky komision nuk është sallë parlamentare. Pra, nëse në parlament deklaratat e anëtarëve të Kuvendit apo ndoshta edhe zyrtarëve të tjerë bëhen edhe pa mbajtur përgjegjësi, këtu çdo lloj deklarimi bëhet duke mbajtur përgjegjësi. Pra, ministri, zëvendësministri, drejtori ose çdo ekspert që vjen këtu për të paraqitur projektligjin, mban përgjegjësi për atë që deklaron. Kjo do të thotë se argumentet që hidhen nga ata që prezantojnë projektligjin janë një element thelbësor për të pranuar ose për të mos pranuar një projektligj,

projektvendim, projektrezolutë apo diçka tjetër. Kështu që, ka qenë në tagrin e gjithsecilit që të vendoste me ndërgjegje të plotë lidhur me aprovimin ose jo të projektligjit.

E fundit që dua të them është se, sigurisht, ne mund ta kishim shtyrë atë projektligj edhe më tej, por incidenti i rëndë që ndodhi këtu me sjelljen e një përfaqësueseje të opozitës, e rëndoi shumë situatën dhe mendoj se në njëfarë mënyre u bë pengesë që projektligji ndoshta të shqyrtohej edhe më me imtësi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk kam nevojë për përkthyes unë nga shqipja në shqip! Po të ishte gjuhë e huaj, mund t'jua pranoja përkthimin!

Situata u rëndua shumë dhe unë, në emër të komisionit, i kam kërkuar falje publikut për atë ngjarje të rëndë, që ndoshta, nëse do të zbatohet me përpikmëri Rregullorja, mund të merrte edhe ndëshkim, por unë, si drejtues i mbledhjes, nuk gjykova të merrja atë lloj tagri.

Kështu që, nëse ka hapësirë ligjore për ta rishqyrtuar, sigurisht që të gjithë kemi pastaj hapësirën e nevojshme dhe lirinë e plotë jo vetëm për të dyshuar, jo vetëm për të mallkuar, jo vetëm për të baltosur, por, në fund të fundit, për të diskutuar me shpirt qytetar në seancë parlamentare. Unë besoj se ne jemi përpjekur këtu në përgjithësi t'i kalojmë gjërat me mirëkuptim, por ndonjëherë takti...

Do të thosha se, përveç atij reflektimi, që ndoshta me të drejtë opozita e ngriti, lidhur me përmbajtjen e projektligjit, është e vërtetë që gjërat duhet të jenë sa më transparente, sa më të qarta, sepse është mënyra se si institucionet kontrollojnë gjërat, fenomenet dhe vendimet, por transparenca ndërkohë na ndihmon që publiku të na kontrollojë, pra të kontrollojë edhe qeverinë, edhe Kuvendin, edhe këtë komision.

Sigurisht, kërkesa për transparencë është një kërkesë legjitime, nuk është jolegjitime, por thashë, komunikimi në mënyrë të gabuar shpeshherë na mundëson të mos jemi të njëzëshëm, por shpesh të dyzëshëm.

Kështu që, do t'ju ftoja që reflektimi të ishte dydimensional, jo njëdimensional.

Faleminderit!

Flutura Açka – Faleminderit, zoti Koçi!

Zonja Gjylameti.

Blerina Gjylameti – Faleminderit, kryetare!

Nuk do të zgjatem shumë, pasi do të doja t'u jepja mundësinë edhe kolegëve të tjerë që të mos vonohemi, por këtë projektligj po e shqyrtojmë në Komisionin përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Normalisht, janë disa procedura që ndiqen dhe ndoshta nuk ka qenë rasti që ju të ishit pjesë e Konferencës së Kryetarëve, ku edhe diskutohet se cilat janë komisionet përgjegjëse për shqyrtim, si dhe kërkohet apo argumentohet se në cilin komision do të shqyrtohet, qoftë në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi apo në komisionin përgjegjës. Kështu që, besoj se ky është një hap i tejkaluar tashmë për t'u diskutuar, që të kthehemi pas për një gjë që ka kaluar.

E dyta, unë besoj se në këtë komision secili prej nesh, në varësi të agjendës personale apo pamundësisë personale, mund të kishte shkruar paraprakisht, të kishte sugjeruar, të kishte propozuar që mbledhja për shqyrtimin e këtij projektligji të shtyhej në një moment të dytë, ku të kishin mundësi të ishin të gjithë anëtarët, gjë e cila nuk u bë. U bë në atë moment, por nuk u bë më parë që të merren të gjitha masat, sepse funksionon procedura parlamentare, në këtë komision jemi të paktë ata që kemi qenë ndër vite, dhe duhet që, sipas afateve të përcaktuara dhe kalendarit të punimeve, të shqyrtohet në të gjitha komisionet për dhënie mendimi e më pas në komisionin përgjegjës. Kjo do të thotë se duhet të ishim organizuar më mirë, nëse do të kishte qenë nevoja që të ishim të gjithë prezentë.

E treta, unë mendoj se sa herë që kemi situata të nxehta debati, qetësia është ajo që duhet të prevalojë. Me qetësi mund të arrijmë të kuptohemi më mirë, mund të jemi më tepër të qartë me njëri-tjetrin, por, mbi të gjitha, me më shumë etikë.

Unë nuk mendoj se këtij komisioni i ka munguar as llogaridhënia dhe më pak t'i ketë munguar transparenca e dokumentacionit përkatës. Marrëveshja është në Kuvend dhe gjithsecili prej nesh ka mundësinë, pa pasur nevojën që të ketë certifikatë sigurie, të konsultohet me marrëveshjet përkatëse dhe të marrë të gjithë informacionin e duhur.

Gjithashtu, në komisionin përgjegjës ne kemi zhvilluar edhe seancë tjetër me persona dhe personalitete të fushës së trashëgimisë kulturore, për të dëgjuar me shumë vëmendje argumentet pro dhe kundër, por, po ashtu, edhe shqetësimet që mund të kemi pasur.

Kështu që, në këtë kontekst, unë besoj se secili prej nesh, pavarësisht se këtu ka kaluar marrëveshja, sipas procedurave në fuqi, por jo në shkelje të procedurave, mund të shkojë në komisionin përgjegjës, sikundër zonja Zhupa është prezent tani, të adresojë shqetësime apo

problematika, të marrë përgjigjen nga institucionet, qoftë nga ministrat, në mënyrë të tillë që të kemi të qartë të gjithë atë çfarë po diskutojmë dhe në fund çfarë do të miratojmë.

Megjithatë, unë nuk mendoj që ne mund të ngremë këtu pretendimin për “shkelje procedurash, sepse ne nuk ishim prezent”; procedura është në rregull për sa kohë është kuorumi. Të thuash që u shqyrtua apo nuk u shqyrtua siç duhet, se ne nuk ishim prezent, më duket se nuk është mënyra e duhur.

Kështu që, në këtë aspekt unë besoj se gjëja e parë që do të duhet, është të mos e shkelim procedurën sot. Kemi në rendin e ditës diskutimin dhe miratimin e kalendarit dhe më pas ejani të ndryshojmë rendin, shtojmë edhe një seancë të dytë për të debatuar, por, ndërkohë, nëse duam të adresojmë problematikat, Komisioni i Ekonomisë është komisioni te dera ngjitur, kalojmë atje, drejtojmë pyetje, marrim përgjigje dhe në fund adresojmë problematikat shumë më tepër sesa të diskutojmë këtu për një procedurë që ka qenë sipas të gjithë kuadrit ligjor në fuqi.

Ju faleminderit!

Ina Zhupa – Faleminderit!

Është e sigurt që seanca e kaluar e këtij komisioni do të shënohet në procesverbalet dhe jetën parlamentare si i vetmi komision, i cili, me urdhër të nënkryetarit, votoi një marrëveshje sekrete pa e lexuar, pa ditur çfarë po firmoste, duke e konsideruar sekret shtetëror dhënien e Butrintit me koncesion, vetëm e vetëm sepse mendonte se kështu e do partia.

Në fillim të seancës së kaluar kam kërkuar për procedurë shtyrjen e asaj seance, për t'i dhënë mundësi që të vinte marrëveshja, por edhe të shqyrtohej nga Konferenca e Kryetarëve mundësia për ta ndërruar komisionin tonë nga komision dhënie mendimi në komision përgjegjës.

Kam pasur fatin këto ditë të shkoja në të gjitha komisionet dhe të shikoja si drejtohen komisionet. Shkova te Komisioni i Politikës së Jashtme, për të thënë kundërpeshën e mënyrës së drejtimit tonë, dhe zoti Tritan Shehu bëri një kërkesë për shtyrjen e diskutimit, sepse ua kishin çuar marrëveshjen, por e kishin çuar vetëm një ditë para dhe ata nuk e kishin lexuar, pasi ishte voluminoze. Zoti Klosi mori vendimin “Po, ta shtyjmë dhe të lexohet patjetër”, kurse këtu unë kërkoja të shtyhet, sepse ne nuk kishim fare marrëveshje dhe po bënim rolin “nuk shikoj e nuk dëgjoj”, njerëz, vegla të partisë, dhe jo vetëm kaq, as nuk u tha pse të mos shtyhej, por iu dha fjala ministres. Pra, ai që drejtonte aty rastësisht, i dha fjalën ministres dhe nuk tha: “Zonja Zhupa, nuk do të shtyhet për një apo më shumë arsye”, por pranoi të ishte ushtar i bindur i partisë, pavarësisht interesave që kishte vendi, se flitej për Butrintin dhe jo për një kioskë të radhës.

Sigurisht, para kësaj shkeljeje të etikës, të Rregullores, nuk do të ishte normale një sjellje e butë dhe përkëdhelëse ndaj një maxhorance, që po vjen dhe po jep me koncesion falas, se thonë nuk po e shesin. Si mund ta shisni Butrintin?! S'ë keni atë tagër ta bëni! Nuk e shet dot qeveria! Nuk blihet Butrinti me paratë e botës, por po ia jepni falas për 10 vjet një fondacioni.

Unë u bëra thirrje edhe kolegëve, të cilët i respektoj për profesionet e tyre, u thashë të mos e votojnë pa e parë një herë, pastaj votojeni në qoftë se ju bind, por ju votuat pa parë asgjë, se ju tha Petro. Ky është turpi që do të ngelet në këtë komision, që nuk do të harrohet edhe në legjislaturat e ardhshme, që do ta marrin si kazus, kur duan të tallen e të shajnë një lloj votimi. Të jeni të sigurt që ai do të jetë rasti. Më vjen keq që do të jetë Komisioni i Edukimit dhe nga kolegët që kam këtu.

Sigurisht, unë nuk mund të ndalesha se donte një nënkryetar i radhës. Kjo gjë është shqyrtuar nga komisioni në komision, ku unë kam qenë pjesë dhe do të jem kudo dhe do të bëj çdo përpjekje, aq sa është mundësia ime dhe e kolegëve të mi për ta ndalur. Në këtë kuadër, meqenëse turpi është juaji, mbajeni! Unë dua për procedurë të shtoj te kalendari diçka. Ne si opozitë kemi një kërkesë: sipas nenit 32, pika 2 dhe nenit 36 pika 1 të Rregullores së Kuvendit kërkojmë një mbledhje të Komisionit të Edukimit dhe Mjeteve të Informimit Publik më datë 17 maj, data e ekzekutimit të Teatrit Kombëtar, ora do të vendoset nga kryesia e grupit, për një seancë dëgjimore me të ftuar këtu zotin Auron Tare, zotin Apollon Baçe, zotin Neritan Ceka dhe me lidhje *skipe* me zotin Agron Alibali, zonjën Rudina Jasini dhe zotin Giora Solar, me përkthim nga anglishtja, që të mos ekzekutohet edhe Butrinti si Teatri, për të dëgjuar mendimet e tyre, për të dëgjuar publiku mendimet e tyre, për të dëgjuar shqiptarët ekspertët, që nuk janë pyetur për këtë aferë, e cila, më vjen keq ta them, është një plan menaxhimi nga një kompani angleze me 500 paund fond dhe me dy ekspertë. Ju miratuat një marrëveshje sekrete për Butrintin për 10 vjetët e ardhshëm. Duke qenë se në kalendar janë dy data për zonjën Muzhaqi, 16 ose 17, atëherë duke qenë se data 17 është kërkesa e Partisë Demokratike, sipas Rregullores për këtë dëgjuesë, zonja Bora i bie të jetë në datën 16 maj, nëse na vjen pas 6 muaj që e kërkojmë Borën, e cila na jep leksione etike, por nuk mbaron dot një fjali dëftore pa gafa.

Së fundi, uroj shumë që ai rast të mbetet i vetmi precedent negativ dhe sigurisht jam e bindur se nën drejtimin tuaj kjo gjë nuk do të ndodhë, por mund të kemi raste të këqija, ku përsëri nënkryetari të marrë drejtimin dhe të mos përsërisë vetveten në asnjë rast. Jam e bindur se nuk është krenar që ka miratuat një marrëveshje sekrete. Ai duhej të ishte i pari që të ngrinte zërin dhe

jo t'i thoshte ministrja që e kuptoj është normale të jetë sekret, sepse kështu e dashka bota. Kjo është video që unë e kam nxjerrë.

Faleminderit!

Flutura Aça- Faleminderit, zonja Zhupa!

Unë do të doja të bëja një shtesë, sepse kam për të thënë disa gjëra në lidhje me atë që tha zonja Gjylameti dhe zoti Koçi. Duhet të dini një gjë që zoti Koçi ka autoritetin e plotë të drejtojnë mbledhjet në mungesën time, kështu që nuk duhet të personalizohen gjërat. Ajo që ka ndodhur është një çështje tjetër, prandaj e futa si procedurë. Po ia them edhe zotit Koçi që e futa si procedurë në mënyrë që të mos shkel Rregulloren e këtij parlamenti, por në asnjë nen të kësaj nuk thuhet sa herë duhet të jetë zoti Koçi këtu dhe sa herë duhet të jem unë. Kështu që nuk është momenti për të diskutuar për gjëra private, të cilat janë bërë publike në mënyrë të papranueshme. Megjithatë, po e them këtë për zotin Koçi. Unë në mungesë të tij e kam lavdëruar për qetësinë me të cilën i ka drejtuar mbledhjet, sepse e kam edhe të njohur herët dhe e di që ka maturinë e duhur për ta drejtuar në mungesën time, kështu që kjo është përtej personales.

Zoti Koçi, atë ditë ne kemi bërë pa dashje “një krim” mbi trashëgiminë kulturore, e thashë në thonjëza, por ne kemi bërë një gabim shumë të madh, sepse, zoti Koçi, këtu thuhet qartë se kjo marrëveshje për të cilën nuk mora përgjigje prej jush, a e keni lexuar ose jo, a keni qenë në Butrint apo jo, sepse asnjëri prej jush nuk më ktheu përgjigje, kjo marrëveshje shkel një nga pikat më të rëndësishme të Konventës së Trashëgimisë Botërore të Parisit të vitit 1972, ku bën pjesë edhe Shqipëria dhe që në nenin 4 të saj thuhet se detyra për të siguruar mbrojtjen, konservimin, propagandimin dhe përcjelljen për brezat e ardhshëm të trashëgimisë kulturore i takon ekskluzivisht shtetit palë. E çfarë kemi ne këtu? Lexojeni dhe do të shikoni se çfarë kemi ne këtu. Pra, çfarë tmerrri kemi ne këtu!

Petro Koçi – Këtu jemi në komision dhe jemi kolegë, pavarësisht se cilës parti i përkasim. Unë mendoj se gjuha provokuese na pengon të ecim më tej, siç duhet. Këtu përdoren epitete, të cilat do të meritonin një reagim nervoz. Unë jam krenar që nuk jam kallëpi i zonjës Zhupa në të gjitha kuptimet, por gjykoj që çdo diskutim për projektligjin, nëse nuk tenton të prekë moralisht anëtarët e komisionit, ata që mendojnë pozitivisht për këtë marrëveshje, mund të jetë më legjitim. Çdo përpjekje tjetër për ta deformuar ose për të shitur një palë ose një individ moral mbi të tjerët, mendoj se e kompromenton rëndë edhe një argument, i cili mund të qëndrojë. Projektligji ka kaluar sipas procedurës normale parlamentare. Ne nuk jemi komision përgjegjës,

por vetëm për dhënie mendimi. Në thelb projektligji përcakton që nuk ndryshon administrimi shtetëror, i siç e ka edhe relacioni, edhe marrëveshja nga shteti, por është një marrëveshje me një fondacion sipas modeleve të ngjashme edhe në vendet e tjera të BE-së.

Gjykoj që çdo hapësirë tjetër për të diskutuar mund të shfrytëzohet, ndoshta mund të bëhet dëgjese me dikë, por në këtë moment që komisioni e ka kaluar kjo është e vështirë, sepse nuk mund të rikthehet procedura e rishqyrtimit. Unë mendoj se në të gjitha hapat e tjera, ku e shqyrtojnë komisionet e tjera, ne kemi lidhjen e plotë jo vetëm për të qenë prezent, por edhe për të diskutuar, edhe për të çuar në seancë një mendim, i cili mund të mos jetë në përputhje me vendimin e këtij komisioni. Ky komision nuk është komision egoistësh, por mendoj që të vijojë marrëdhënia etike mes anëtarëve të këtij komisioni, duhet të hiqet dorë nga epitete që janë provokuese. Mua më vjen keq, sidomos kur këto përdoren nga kolege, është edhe më e rëndë. Unë e kuptoj se zakonisht damkën e provokimeve e kanë burrat, nuk është gjë e mirë ta pranoj se edhe unë i përkas atyre, por mendoj se kjo nuk është normale dhe nuk është mirë t'i ftoj njerëzit të vetëpërbahen.

Faleminderit!

Eduard Ndreca - Faleminderit!

Unë mendoj se jemi në kohën për të thjeshtuar gjërat. Në Konferencën e Kryetarëve kam qenë dëshmitar i asaj që u diskutua pas asaj që ndodhi në këtë komision. Atje, zoti Alibeaj, së bashku me Kryetaren e Kuvendit dhe kryetarin e Komisionit përgjegjës të Ekonomisë dakordësuan së bashku që seti i pyetjeve dhe vërejtjeve që duhej të bëhej në këtë komision, sepse me të drejtë e shtruat edhe ju, se kishte një ngërç në shfaqjen e kontratës, pra të gjitha diskutimet që kanë mbetur pa u bërë, të bëhen në Komisionin e Ekonomisë, në komisionin përgjegjës, ku do të marrë pjesë edhe zonja Zhupa. Unë mendoj se ky diskutim e ka marrë zgjidhjen në Konferencën e Kryetarëve me dakordësinë e të gjitha grupeve atje, që çështja të adresohet dhe secili prej nesh, por konkretisht çështja u lidh me zonjën Zhupa, të merrte pjesë në Komisionin e Ekonomisë dhe besoj se zonja Zhupa ka marrë pjesë dhe ka drejtuar të gjitha pyetjet që ka pasur.

Tani, çështja a jemi apo nuk jemi në komisionin përgjegjës, patjetër që ha diskutim. Unë kam kolegët e mi në Komisionin e Ekonomisë dhe nëse unë kërkoj që kjo çështje të jetë këtu dhe duhet të jetë patjetër këtu, më duket sikur zbeh besimin ndaj kolegëve të mi në atë komision, kështu që të gjitha forcat politike, ose maxhoranca dhe opozita kanë përfaqësues të tyre në të gjitha komisionet dhe është i njëjtë reagimi. Ne nuk kemi pse e lidhim këtë çështje thjesht me reagimin tonë këtu, kështu që unë mendoj se është thjeshtuar gjëja në Konferencën e Kryetarëve dhe nuk

kemi pse kalojmë në debate, duke kapërcyer edhe etikën për njëri - tjetrin. Ne e kemi duruar këtë edhe në mbledhjen tjetër, në fakt. Unë mendoj se meqë këtë sallë do ta ndajmë për 4 vjet së bashku, nuk duhet ta humbim durimin së paku me njëri-tjetrin. Ne mund të flasim, të kritikojmë, të kërkojmë llogari, të bëjmë pyetje dhe diskutime nga më të ndryshmet, të akuzojmë për çdo gjë që e shohim të arsyeshme, por me njëri-tjetrin e quaj totalisht të pahijshme që të merremi. Unë e refuzoj dhe do ta refuzoj totalisht këtë qasje sa të jem këtu. Unë mendoj se duhet të ndalemi te thelbi i gjësë; të mos tërheqim as vëmendjen jashtë me debate dhe kapërcim etike përballë njëri - tjetrit.

Miqësisht po ju them se Konferenca e Kryetarëve e ka dhënë zgjidhjen; ju mund të pyesni dhe të merrni informacion edhe vetë. Unë besoj se është organi më i lartë politik që drejton të gjitha punët tona.

Faleminderit!

Flutura Açka – Faleminderit!

Në fakt, çështja ishte që ne na ka munguar drafti, këtu e kam problemin, nuk e kam te procedura. Unë kam qenë në Komisionin e Ekonomisë, i kam dëgjuar specialistët, ata që ne nuk i kemi dëgjuar, por që duhej t'i dëgjonim ne. Madje unë kam një propozim që një nga ata zotërinjtë ta thërrasim të mërkurën, nëse mundet, për të na e bërë më të qartë situatën, që të jemi të larë në ndërgjegjen tonë, sepse kemi kaluar një gjë që nuk e kemi lexuar. Ky është shqetësimi im, nuk është shqetësimi im a janë ndjekur procedurat për t'u kaluar ky draft.

Ne kemi votuar një gjë që nuk e kemi parë, kjo është çështja dhe unë e kam për veten timen me ndërgjegjen; unë këtu e kam problemin dhe mendoj se edhe kolegët e mi e kanë këtë. Unë nuk po fajësoj askënd, por ne kemi bërë një gjë symbyllur, kemi votuar një gjë symbyllur. Ajo që më ka bërë përshtypje atë ditë, zoti Ndreca, është që të gjithë zëvendësuesit atë ditë janë paraqitur këtu si në rreshtore, do të thotë që ju e kishit të ndarë mendjen për ta kaluar këtë krim, po e them edhe një herë. Nëse ka një nishan ky komb, ka Butrintin, dhe kujt po ia japim ne këtë? Po ia japim Hobsit që ta bëjë grek?! Vazhdoni shkoni dhe në parlament dhe votojeni, bëhuni pjesë e kësaj farse, por unë ju këshilloj si njeri, si qytetare, si kryetare e komisionit, si Flutur, si njeri që deri para një viti nuk kam pasur fare të bëj me politikën, ju them se Butrinti ka nevojë për mbështetjen e secilit prej nesh, sepse nuk është vetëm për ne, por është për ata që vijnë pas dhe ky draft do ta vërë këtë gjë në dyshim, në mënyrën si është ndërtuar dhe jua shpjegova edhe në lidhje me çfarë neni keni shkelur.

Propozimi i dytë është për zotin Karaiskaj, nëse është e mundur ta thërrasim ditën e mërkurë; kam folur me profesorin, i kam thënë se do të vendosim në komisionin pastaj do ta ftoj. Nuk ka asnjë lloj debati, por për të na sqaruar ne se çfarë po bëhet, ose të flasë për Butrintin për pasionet e tij.

Propozimi i dytë është personal, por mund të më ndiqni edhe ju. I kam ndjekur të gjitha seancat që kanë lidhje me Butrintin; unë kam ndërmend të bëj një shkresë qoftë edhe në emrin tim personal, por mund ta bëj në emër të komisionit dhe t'ia drejtojmë UNESCO-s, sepse ministrja tha se kemi marrë miratimin e UNESCO-s. UNESCO-ja nuk jep miratim, thjesht duhet ta njoftosh që ke bërë këtë gjë, por varet se për çfarë janë njoftuar dhe unë do të njoftoj të gjitha hollësitë që kanë lidhje me këtë draft, sepse jam e detyruar dhe ftoj, sigurisht, kolegët e opozitës ta firmosin. Nëse dëshironi të bëheni pjesë për të mbrojtur, Butrintin jeni të hapur.

Zonja Buxheli e ka fjalën.

Lindita Buxheli - Faleminderit, duke qenë se isha që nga fillimi deri në fund të mbledhjes së komisionit të kaluar, më duhet të sqaroj dy gjëra shkurtimisht. Së pari, do të ishte mirë të ishte edhe zonja Zhupa, e cila na tha se jemi të mashtruar dhe të imponuar. Absolutisht nuk e ndjej vetën të mashtruar, sepse e kam dëgjuar më shumë vëmendje ministren edhe unë kam mendimet mia ndryshe, kam bërë pyetje, jam sqaruar për atë pjesë, por e imponuar jo. Kemi 8 muaj si anëtarë të komisionit dhe le të thotë një njeri nga grupi jonë i maxhorancës që zoti Petro na ka detyruar ose imponuar për një vendim të caktuar. Absolutisht jo!

Flutura Açka- Zoti Boçi.

Luçiano Boçi - Faleminderit, kryetare!

Tani këto debatet që janë zhvilluar dhe po vazhdojnë, për mua janë *deja vu* e debateve të zhvilluara për Butrintin në vitin 2017. Për fatin e mirë unë kam qenë pjesë e atyre debateve dhe kemi luftuar fort që Butrinti të mos i jepej me qira një firme sallami, firmës “Hako”, mirëpo e mori në vitin 2017 dhe e menaxhoi për 5 vjet, pavarësisht se Kontrolli i Lartë i Shtetit e nxori marrëveshjen e bërë midis Ministrisë së Kulturës dhe firmës së sallamit me shkelje shumë të rënda. Tani, nga sallami të Hobsi duket evolucion goxha i madh dhe shpresoj që firma e sallamit për Butrintin të mos ketë qenë zhgënjim pozitiv. Për të mos qenë i tillë, unë do të doja që firma në fjalë, që ka menaxhuar për 5 vjet një nga sitet më të rëndësishme të Shqipërisë, të vijë dhe të na reagojë arritjet e saj, me qëllim që këto arritje të merren pas nga fondi dhe të çohen më tej nga mënyra si është menaxhuar Butrinti, dhe të mos biem në justifikime që “jo, u detyruam, jo nuk po

themi se ka pasur detyrime të karakterit personal”. Detyrimet janë të karakterit politik, por që të dalim të pjesa e mashtrimit, përderisa këtu debatohet pa pasur projektin e plotë, atëherë konceptohet shumë thjeshtë që është mashtrim. Ne duhet të kërkojmë që debati ynë të ndërtohet mbi bazën e njohjes së plotë të projektit. Pra, kemi një përvojë të dështuar 5 vjet me qira e mori një firmë sallami Butrintin; nuk kemi ndonjë rezultat. Rezultati duhet të jetë negativ, përderisa kalohet në një stad tjetër nga dhënia me qira që ishte atëherë e paligjshme; sipas ligjit kalohet në dhënien me koncesion. Dhe ne duhet të kemi edhe detyrimin që të shohim edhe evolucionet, sepse mbyll sytë dhe jepja njërit, mbyll sytë dhe jepja tjetrit trashëgiminë tonë kulturore, kjo nuk duhet të ndodhë, sepse duhet t’i thërrasim edhe memories në këtë komision. Debatet kanë qenë shumë të forta atëherë dhe e kemi vënë në poezitë të vështirë ministren, dhe kemi qenë çuditërisht komision përgjegjës. Sot ne nuk jemi komision përgjegjës, pra është përdorur një derë dhelprë që të kalojë te Komisioni i Ekonomisë, të mos kalojë nga komisioni ynë. Jo se ne jemi më të mirë se ata, por edhe kemi ndjeshmërinë ndoshta më të madhe, për shkak të formatit të përbërjes së komisionit.

Prandaj, në konsideratat që kemi dhënë ose që ju keni dhënë, më saktë të kemi një rikthim pas, të kemi projektin e plotë siç e thotë dhe kryetarja, të kemi në konsideratë edhe historinë se çfarë ka ndodhur me Butrintin dhe, më pas, të shprehemi. Të mos harrojmë se njëri prej përfaqësuesve tuaj atëherë, nuk dua ta përmend për arsye etike me emër, që është shumë i njohur dhe që është marrë shumë me kulturën, ka sjellë këtu në komision një shembull, po të hapen procesverbalet e gjeni aty, ka qenë në Kroaci, në një nga sitet më të famshme, dhe thoshte se atje edhe shishen e ujit nuk ta lejonin me vete, sepse ndotet ambienti i sitit arkeologjik, jo më ta mendoni të bëhen hoteleri ose ndërtime të tjera brenda sipërfaqes së sitit më të rëndësishëm arkeologjik! A e kuptoni se çfarë dëmi po i sjellim trashëgimisë kulturore?! Të paktën ne që jemi votuar për të pasur përgjegjshmërinë më të lartë, duhet të reagojmë. Pra, si duhet të reagojmë? Ndërkohë të zhvillojmë seancat dëgjimore, jam shumë dakord, të ftojme edhe përfaqësuesit e firmës që e kishte me qira, pavarësisht aktivitetit që ka të ndryshëm nga kultura dhe t’i marrim një relacion të suksesit të madh apo të vogël, ose mesatar që ai ka pasur në mënyrën si ka menaxhuar Butrintin. Kontrata ka qenë e firmosur në maj dhe mbaron në maj dhe pa mbaruar kontrata, ju përgatitët dhënien me koncesion. Nuk është gjë e rastit kjo; kjo ishte e përgatitur mirë! Të mos mbyllim sytë dhe të votojmë çfarë na vjen këtu.

Zoti Koçi e ka drejtuar me shumë qytetari komisionin kur ka munguar zonja Açka dhe nuk kemi parë as imponime, as detyrime, përkundër kësaj kemi pasur një gjuhë të moderuar, por ne e dimë shumë mirë që imponimet politike kanë forma të tjera, nuk kanë forma për shfaqje ligjëruese, por kanë forma shfaqjeje vendimmarrëse.

Propozimi im është që t'i ftojme dhe ata përfaqësues që e menaxhuan për 5 vjet Butrintin dhe të shohim arritjet që kanë sjellë në menaxhimin e Butrintit, kjo për çështje përvoje.

Flutura Açka – Po, zonja Zake.

Enslemvera Zake - Përshëndetje!

Vë re në mënyrë të përsëritur që ka një mungesë të theksuar informacioni. Unë, si pjesë edhe e Komisionit të Ekonomisë, dua t'ju bëj me dije se marrëveshja është transparente së bashku me anekset përkatëse. Aktualisht po shqyrtohet në Komisionin e Ekonomisë. Ne kemi zhvilluar disa seanca dëgjimore me ministren dhe me përfaqësues të tjerë të institucioneve të varësisë ose të tjera që kanë lidhje me Butrintin. Ne kemi lidhur me pyetjet dhe dyshimet që kanë pasur kolegët e komisionit, i jemi drejtuar me shkrim ministres së Kulturës dhe aktualisht në Komisionin e Ekonomisë ajo po përgjigjet për të gjitha pyetjet, si nga ana e kolegëve të opozitës, por edhe nga ana e kolegëve të pozitës.

Gjithashtu, atje kemi përfaqësues të Institutit të Arkeologjisë, rektorin e universitetit, studentë, kemi përfaqësues të Ministrisë së Financave, ministren, pra të gjitha strukturat që kanë lidhje dhe janë subjekt i kësaj marrëveshjeje.

Ndërsa në lidhje me çështjen a duhet të ishim komision përgjegjës apo komision për dhënie mendimi, tani është ezauruar, pasi është vendosur në Konferencën e Kryetarëve dhe, ashtu siç jua sqaroi kolegu Ndreca, besoj se të gjithë kolegët kanë tagrin për të qenë pjesë e Komisionit të Ekonomisë dhe për të sqaruar apo për të shuar të gjitha dyshimet që mund të kenë lidhur me vazhdimësinë apo me të ardhmen e Butrintit.

Ju faleminderit!

Flutura Açka – Faleminderit, zonja Zake!

Jam e detyruar ta përsëris pyetjen: ne si e kaluam? Këtu e kam unë problemin. Ne si e kaluam pa e lexuar këtë draft? Ky është shqetësimi im, te procedura që ka ndodhur në këtë komision. Këtu ky draft nuk ka ardhur. Siç e dëgjua, zonja ministre tha që është sekret, kur, në fakt, në një program televiziv tha që nuk ekziston fare plani i biznesit. Në momentin që ka kaluar

në komision këtu te ne, ky draft nuk ka qenë i depozituar. Askush nuk e ka lexuar deri atë ditë, kjo është çështja, ky është shqetësimi im!

Po, zoti Ajazi, fjala është për ju.

Besion Ajazi – Faleminderit, zonja kryetare!

Në mbledhjen e sotme erdha pak me vonesë, por kam qenë në mbledhjet, kur e kemi marrë në shqyrtim dhe e kemi miratuar këtë projektligj. Komisioni ynë ka kryer punë me këtë projektligj, ka marrë votat e anëtarëve të tij, si komision për dhënie mendimi, kemi pasur ministren të ftuar, e kemi pyetur për çfarë na ka interesuar dhe për çka ne kemi menduar se është e rëndësishme, kemi marrë përgjigjet dhe në fund e kemi votuar. Nuk i di këto deklaratimet e ministres, që paska qenë sekret, nuk tregohet, është e fshehtë, nuk marr përsipër t’i them, por di që, edhe si anëtar i Komisionit të Jashtëm, na është paraqitur i gjithë informacioni dhe i gjithë dokumentacioni i nevojshëm...

Flutura Açka – Unë, si kryetare, nuk e kam pasur draftin.

Besion Ajazi – Unë flas për personin tim, edhe si anëtar i Komisionit të Politikës së Jashtme. Megjithatë, nuk dua të them ndonjë shprehje popullore, por kjo gjë ka kaluar. Nuk e di kë po qajmë tani? Të mos i marrim kohën këtij komisioni të nderuar me gjëra që nuk na takojnë neve tashmë. Ajo që na takonte me ligj dhe me Rregullore të Kuvendit është që, si komision për dhënie mendimi, të jepnim mendimin tonë; e dhamë mendimin tonë, e kemi kaluar, është në proces në komisionin përgjegjës, në Komisionin për Ekonominë dhe Financat.

Në këto kushte janë kolegët atje që po e diskutojnë në themel këtë gjë, sigurisht duke qenë jo vetëm ministrja, por edhe drejtues të institucioneve të tjera. Nuk do të bëhemi pjesë tani që të rihapim diçka që proceduralisht ka kaluar konform rregullave dhe ligjeve; nuk mund të thërrasim firmën që ka qenë të tregojë performancën, një arkeolog e të tjera, sepse nuk janë gjëra që na përkasin. Kemi mbaruar punë me këtë projektligj, e nderuar.

Kështu që, unë them të mos i marrim kohën kot as vetes sonë, as komisionit dhe as njerëzve që na ndjekin, sepse nuk kemi asnjë peng me veten dhe nuk kemi bërë as ndonjë presion. Kemi bërë punën tonë të përditshme dhe do ta bëjmë në zbatim të ligjit dhe të atyre që na kanë votuar.

Faleminderit!

Flutura Açka – Faleminderit, zoti Ajazi!

E kuptoj që e keni ndarë mendjen, u është dukur një punë e bukur, edhe pse është një ndërtim i radhës pa leje në kulturën shqiptare, por vazhdoni, është çështja juaj. Në fund të fundit, secili prej nesh është betuar përpara shqiptarëve që do të silltet në mënyrën më të mirë të mundshme në dobi të shqiptarëve. Kështu që, në ndërgjegjen tuaj bëni si të doni, votojeni ose jo, por ta dini që Butrinti është një halë shumë e fortë për secilin prej nesh dhe e kemi obligim, të mos e përsëris shumë herë, e kemi obligim ta mbrojmë.

Kur njëfarë Hodges, një Richard, që është anëtar bordi, mes 5 anëtarëve, e thotë, e deklaron, e ka të botuar të zezë mbi të bardhë, shikojeni, lexoni librat e tij që botohen në Shqipëri, në një vend tjetër do të ishte shpallur “*non grata*” zotëria, por në këtë vend, siç thotë Kryeministri juaj, “rrumpallë” edhe ndodhin këto gjëra, ekskluzivisht me gojën e tij, me shkrimin e tij, me emrin e tij ai thotë që Butrinti ka fatkeqësinë që në vitin 1913 nuk iu la Greqisë, por ai harron që, në fakt, Çamëria është deri tek Ura e Artës, apo ku di unë, dhe nuk është Greqi aty ku është Butrinti. Por ai ka marrë një mision që këto 10 vjet t’ia ndryshojë historinë Butrintit. Problemi është që kjo gjë është “thembër Akili”, për të cilën duhet të mbetemi dhe të jemi të kujdesshëm. Nuk keni dëshirë, është çështja juaj!

Faleminderit!

Ka dikush vërejtje për rendin e ditës? Ka ndonjë shtesë?

Petro Koçi – Datat mendoj t’i vendosim në vijim; disa momente janë pa data këtu, disa seanca dëgjimore.

Flutura Açka – Seanca dëgjimore për nesër është e qartë, apo jo?

Petro Koçi – Për këtë javë është në rregull, po flas për javën e ardhshme. Në parim ta kalojmë kështu siç është.

Flutura Açka – Po për të mërkurën, datën 11, për miratimin e projektrezolutës, për raportin? Janë të vendosura këto? Është me pikëpyetje, ndaj po ju them.

Petro Koçi – Ora nuk është.

Flutura Açka – Për orën do ta diskutojmë deri pasnesër, atëherë?

Eduard Ndreca – Është mirë që edhe me oraret të rakordojmë me komisionet e tjera, në mënyrë që të mos kemi përplasje me to, sepse lëviz nga një komision në tjetrin.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në rregull, nëse është parë rakordimi.

Petro Koçi – Nëse do të ketë ndonjë gjë në vijim, edhe mund ta ndryshojmë.

Flutura Aça – Për seancën dëgjimore me zonjën Bora Muzhaqi, ju lutem, a mund ta lemë të hënën? Ia lemë të hapur zonjës Muzhaqi, që të gjejë ajo një kohë të përshtatshme, se edhe kjo që është tejzgjatur shumë, nuk shkon më.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mund t'i lihet asaj një hapësirë, që të ketë mundësi të paraqitet. Ju lutem, stafi ta njoftojë, sepse ajo ka një veprimtari disamujore, por e mira është të raportojë, sepse u zgjat si shumë. Është në rregull të hënën, në datën 16 dhe orarin e vendosim më vonë? Atëherë, shënojmë datën 16? Dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Petro Koçi – Përtej diskutimit moral, nga ana procedurale kjo është një gjë që ka kaluar. Unë e kuptoj që është diçka që vlen të diskutohet gjatë, sepse, pa dashur të bëhemi njëri më patriot se tjetri, mendoj se në komisionet e tjera, ku kjo çështje është në vijim, mund të sugjerohet që këta edhe mund të thirren. Mendoj se një rikthim nuk do të ishte dinjitoz për asnjërin këtu.

Besion Ajazi – Nuk është e mundur edhe nga ana procedurale.

Flutura Aça – E para, është propozimi i 1/3 së deputetëve të komisionit, është normale dhe, e dyta, s'ka asnjë gjë të keqe, sepse është përpara seancës parlamentare dhe është normale të diskutohet për këtë çështje, përderisa te ne nuk është diskutuar në këtë thellësi. Madje, unë jua thashë, kam folur me profesorin, me njërin nga zotërinjtë, por nëse do të duhet diçka më e madhe, le të jetë diçka më e madhe, aq më mirë akoma. Është një gjë brenda procedurave, nuk ka asgjë jashtë procedurave. Na duhet vetëm të vendosim datën. Propozoni një datë. Zonja Zhupa propozoi datën 17. Do ta vendosim për propozimin? Stafi, ju lutem, propozimin ta kaloni *online*.

Besion Ajazi – Të shqyrtojmë propozimin?

Flutura Aça – Jo të shqyrtoni propozimin, të vendosim për seancën dëgjimore para seancës parlamentare për komisionin tonë, zoti Ajazi, këtë po them! U hodh propozimi, që është me 1/3 e anëtarëve të komisionit dhe është hedhur për shqyrtim. Ta vendosim bashkë, nëse do ta bëjmë apo jo. Pse ka kundërshti për të mos e bërë përpara seancës parlamentare? Dëgjesa te ne nuk është bërë; është normale të bëhet, nuk ka asgjë kundër dëgjesës.

Besion Ajazi – Realisht nuk e di: si komision për dhënie mendimi, a mund të bëjmë dëgjesa?

Flutura Aça – Po, s'ka asnjë gjë! E keni shumë të qartë në Rregullore, mund t'jua jap unë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Eduard Ndreca – Deri në datën 17 janë edhe disa ditë, kështu që në mbledhjen e nesërme ose të pasnesërme ne po rakordojmë përfundimisht në lidhje me këtë çështje, ta shtyjmë këtë diskutim për nesër ose pasnesër, pastaj rakordojmë. Kjo është një çështje që hidhet në votim këtu, por edhe ne të rakordojmë me njëri-tjetrin, që të jemi në një linjë.

Faleminderit!

Flutura Açka – Kemi edhe në vazhdim, në bazë të kalendarit, pastaj do të vendosim më vonë dora-dorës se çfarë do të bëjmë me dëgjesat.

Për kalendarin jeni dakord që një nga datat e ardhshme do të jetë për dëgjesën? Dakord!

Numri i votave është në rregull? 11 vota pro.

Një nga kërkesat që u shtua është ajo për seancë dëgjimore me arkeologë, me specialistë të Butrintit, që do të bëhet e hapur me anëtarët e komisionit tonë, kështu që do të vendoset data në një nga datat e ardhshme, por që jemi dakord në parim për dëgjesën.

Faleminderit!

Petro Koçi – Tani po ngatërrohem. Ne tani kaluam kalendarin, votohet kush është pro, kundër, abstenim. Ishin 11 pro, apo jo? Edhe kërkesa tjetër duhet hedhur në votim.

Flutura Açka – Po, e thamë më përpara kërkesën, madje folëm edhe për datën dhe datën e lamë të hapur.

Petro Koçi – Zoti Ndreca tha që të mos e diskutojmë sot, por në një mbledhje të ardhshme.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Flutura Açka – Ju thatë që jeni dakord për t'u bërë!

Petro Koçi – Jo, unë nuk jam dakord. Unë jam zëvendëskryetar i komisionit dhe nuk bëj më dëgjesa.

Eduard Ndreca – Kjo hidhet në votim. Unë thashë ta kalojmë për nesër, ju diskutojeni njëherë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Është ezauruar kjo çështje në Konferencën e Kryetarëve, pra edhe ju duhet të merrni miratimin e kryetarit të grupit parlamentar, ta diskutoni edhe ju. Besoj se do të jetë në kundërshtim edhe me këtë kërkesën tuaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk e keni diskutuar, sepse në Konferencën e Kryetarëve është vendosur ndryshe. Unë nuk di të ketë një organ më të lartë politik, që na orienton neve si grupe parlamentare.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Konferenca e Kryetarëve ka vendosur zgjidhjen e këtij problemi; besoj se edhe ne me tonën, edhe ju me tuajën, s'jemi në një linjë. Ju mund të pyesni dhe e shtyjme për nesër.

Flutura Açka – Zoti Ndreca, është dorëzuar një kërkesë dhe sigurisht do ta marrë parasysh edhe Konferenca e Kryetarëve, sepse nuk mund të shpëtojë Konferenca pa u marrë me këtë gjë, por ne po e themi në parim që në këtë komision ne mund ta bëjmë këtë gjë, sepse është një gjë që nuk e kemi bërë.

Eduard Ndreca – Në Konferencën e Kryetarëve u paraqit një kërkesë e zonjës Ina Zhupa, që mund të jetë e njëjta me këtë, apo mund të jetë tjetër, nuk e di. Konferenca e Kryetarëve diskutoi për gati 1 orë kërkesën e zonjës Zhupa dhe vendosi atë zgjidhje që thashë më parë këtu, me dakordësinë e kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, me dakordësinë e kryetarit të komisionit përgjegjës, kryetarit të Komisionit të Ekonomisë, dhe të gjithë Konferencës së Kryetarëve. Pra, u gjet zgjidhja dhe u caktua në atë Konferencë. Nuk besoj se ne si komision mund të dalim përtej vendimit që mori Konferenca e Kryetarëve, për t'u diskutuar, aq më tepër kur ne e kemi kaluar këtë çështje. Mund të ketë komisione të tjera që nuk e kanë trajtuar, kjo çështje mund t'u kalohet komisioneve të tjera, dëgjesa mund të bëhet në komisione të tjera, mund të marrim pjesë edhe ne si anëtarë të këtij komisioni në komisione të tjera, na e jep Rregullorja këtë të drejtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ne nuk votojmë, se e kemi votuar një herë. Pra, për dëgjese ne mund të marrim pjesë edhe në komisione të tjera. Ta kalojmë për diskutim nesër dhe nesër ta votojmë, nëse jemi pro për ta vendosur në kalendar, apo nuk jemi pro.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ne nuk vendosëm këtë në kalendar, ne votuam një kalendar...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ne mund të kemi shtesa rrugës në kalendar.

Flutura Açka – Nëse ju nuk jeni dakord, në rregull.

Petro Koçi – Unë nuk jam dakord. Nëse shumica vendos të jetë dakord, le ta bëjë.

Besion Ajazi – Zonja Kryetare, unë jam në mbështetje të propozimit të zotit Ndreca, që ne kemi mbledhje edhe në datën 10, pra nesër, dhe pasnesër në datën 11. Kemi kohë që edhe ta diskutojmë, edhe të vendosim.

Faleminderit!

Flutura Aça – A është dikush tjetër që dëshiron të shtojë diçka?

Atëherë, ta quajmë kalendarin të miratuar dhe mbledhjen të mbyllur.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA

